



**ME VEPRIM TË PËRBASHKËT DERI TEK
RESPEKTIMI MË I MADH I TË DREJTAVE TË
GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK**

PUNONJËS TË SIGURT MEDIATIK PËR NJË GAZETARI
KUALITATIVE NË MAQEDONINË E VERIUT

ANALIZË - GJENDJA SOCIO-EKONOMIKE
DHE E SIGURISË NË MEDIA

**ME VEPRIM TË
PËRBASHKËT
DERI TEK RESPEKTIMI
MË I MADH I TË
DREJTAVE TË
GAZETARËVE
DHE PUNONJËSVE
MEDIATIK**

Shkup, 2022



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë., Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.

PUNONJËS TË SIGURT MEDIATIK PËR NJË GAZETARI
KUALITATIVE NË MAQEDONINË E VERIUT

ANALIZË - GJENDJA SOCIO-EKONOMIKE
DHE E SIGURISË NË MEDIA

**ME VEPRIM TË
PËRBASHKËT
DERI TEK RESPEKTIMI
MË I MADH I TË
DREJTAVE TË
GAZETARËVE
DHE PUNONJËSVE
MEDIATIK**

Shkup, 2022

Titull

ME VEPRIM TË PËRBASHKËT DERI TEK RESPEKTIMI MË I MADH
I TË DREJTAVE TË GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Autorët

Biljana Bejkova Joshevska
Sead Dzigal

Redaktor

Darko Duridanski

Botues

SSNM

Projekt

Punonjës të sigurt mediatik për gazetari kualitative në Maqedoni

Përktheu në shqip

Ferikan Ilijazi

Dizajn grafik

Aleksandar Vasilevski

Shtyp

Datapons, Shkupi

Tirazhi

250

Shkupi, janar 2022

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

070:331.105.441(497.7)(047.31)
331.45/.48:070(497.7)(047.31)

БЕЈКОВА Јошеска, Билјана

Со заедничко дејствување до поголемо почитување на правата на новинарите и на медиумските работници / [автори Билјана Бејкова Јошеска, Сеад Џигал ; [превод на албански јазик] Ферикан Илјази]. - Скопје : Самостоен синдикат на новинари и медиумски работници - ССНМ, 2022. - 46, 46 стр. : илустр. ; 21 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Me veprim të përbashkët deri tek respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik / [autorët Biljana Bejkova Joshevska Sead Dzigal ; përktheu në shqip Ferikan Ilijazi]. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Библиографија: стр. 44-46. - Проект: Безбедни медиумски работници за квалитетно новинарство во Северна Македонија

ISBN 978-608-65669-2-0

1. Џигал, Сеад [автор]

а) Новинарство -- Синдикални организации -- Македонија -- Истражувања б)
Безбедност при работа -- Новинарство -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 56279813

PËRMBAJTJA

REZYME	7
HYRJE	8
Metodologjia e hulumtimit	11
Qëllimi i hulumtimit	11
Qasja metodologjike në hulumtim	12
Gjetjet kryesore nga anketa e zhvilluar	14
Gjendja socio-ekonomike e gazetarëve dhe punonjësve mediatik	14
Kushte për punë dhe transformim digjital	14
Organizimi sindikalist	15
Barazia gjinore	15
Siguria dhe presionet në punë	15
Vështrim i rezultateve të anketës	17
Karakteristikat demografike dhe profesionale të gazetarëve dhe punonjësve mediatik	17
Pozita ekonomike e gazetarëve dhe punonjësve mediatik	21
Të drejta dhe obligime në marrëdhëniet e punës	24
Organizimi sindikal dhe qasja ndaj sindikatave	28

Sigurimi dhe respektimi i barazisë gjinore	30
Siguria gjatë punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik	33
Konkluzë	37
Rekomandime	40
REKOMANDIME KONKRETE:	43
BIBLIOGRAFIA	44

REZYME

Për tejkalimin e problemeve dhe gjendjeve të komplikua me të cilat ballafaqohen gazetarët dhe punonjësit mediatik në Maqedoninë e Veriut, duhet përforsim i vazhdueshëm i shoqatave relevante mediatike dhe organizatave sindikale. Ata kujdesen për mbrojtjen e interesave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në mënyrë të organizuar, dhe duhet të jenë aktorët kryesorë në realizimin e të drejtave të tyre profesionale dhe të punës. Në mënyrë që të ndihmohet dhe përforskohet puna e punonjësve mediatik, është e nevojshme që të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për gjendjen reale dhe problemet e shoqërisë mediatike si dhe një vlerësim dhe analizë të faktorëve, metodave dhe mënyrave kryesore për tejkalimin e tyre.

Me mbledhjen e të dhënave relevante për gjendjen reale në sektorin mediatik në mënyrë direkte nga të punësuarit dhe personat e angazhuar në media, ky hulumtim jep një bazë solide për vlerësim dhe analizë të gjendjes aktuale me të drejtat profesionale dhe të punëtorit në media.

Nëpërmjet anketave, fokus grupeve, mbledhjeve konsultuese dhe desk-analizave, kemi fituar të dhëna lidhur me respektimin e të drejtave profesionale dhe lirinë e shprehjes së gazetarëve dhe punonjësve mediatik, sigurinë e tyre, të drejtat e tyre të punëtorit, si dhe për nivelin e integritit të barazisë gjinore në punën e mediave.

Rezultatet e fituara nga hulumtimi e vërtetojnë gjendjen e keqe socio-ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nevojën për përmirësimin e të drejtave të punëtorit, organizimin sindikal dhe sigurinë, si dhe domosdoshmërinë për marrjen e masave dhe aktiviteteve plotësuese për avancimin e barazisë gjinore në media.

Po ashtu hulumtimi ka treguar se një numër i konsiderueshëm i gazetarëve dhe punonjësve mediatik nuk kanë besim tek institucionet të cilat duhet t'iu garantojnë realizimin e të drejtave të tyre profesionale e punëtore, lirinë dhe sigurinë. Rritja e besimit tek mbështetja institucionale duhet të vendoset në fokusin e aktiviteteve të ardhshme dhe koordinimin e bashkëpunimit mes SHGM-së dhe SPGPM-së (Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatik) me institucionet përgjegjëse dhe faktorët kyç në shtet.

HYRJE

Pas avancimit për tre vende në rang listën për lirinë e mediave të Reporterëve pa kufij për vitin 2020, Maqedonia e Veriut edhe në vitin 2021 ka avancuar, kësaj here për dy pozita¹. Megjithatë, ky avancim duhet të interpretohet me kujdes edhe në kontekst të listës së gjatë të reformave të pa plotësuara për përmirësimin e gjendjes me mediat në shtet, si dhe nëpërmjet prizmit të ndikimeve të tjera negative siç janë pandemia në vitin 2020 dhe në vitin 2021², dhe kushtet e përkeqësuar socio-ekonomike për punë të gazetarëve, punonjësve mediatik dhe mediat në përgjithësi.

Sipas raportit më të ri të Reporterëve pa kufij, problemet në punën e mediave dhe gazetarëve më së shpeshti manifestohen nëpërmjet kërcënimeve nga përfaqësues qeveritar, keqtrajtimi dhe sulmet online në rrjetet sociale , si dhe nëpërmjet përforsimit të kulturës së mosndëshkimit ndaj personave dhe grupeve që e pamundësojnë apo vështirësojnë punën e mediave dhe gazetarëve.

1 Maqedonia e Veriut është në vendin e 90-të në botë për lirinë e mediave sipas indeksit të Reporterëve pa kufij. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

2 Organization for Security and Co-operation in Europe, The Representative on Freedom of the Media, Harlem Désir, *Regular Report to the Permanent Council for the period from 21 November 2019 to 2 July 2020* faq. 10-59.

Situata me mediat në dy vitet e fundit po përkeqësohet gradualisht, ndërsa analizat dhe raportet tregojnë se po vazhdon praktika që përfaqësues të lartë qeveritar tu kërcënohen dhe ti ofendojnë gazetarët dhe punonjësit mediatik, por, në rritje janë edhe kërcënimet dhe sulmet verbale, sidomos nëpërmjet mediave online dhe rrjeteve sociale. Këto trende dhe procese ndikojnë në përforcimin e kulturës së vazhdueshme të mosndëshkimit të autorëve të veprave të tilla kundër gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Ministria e drejtësisë gjatë muajit korrik të vitit 2021 informoi se Qeveria i ka miratuar ndryshimet në Kodin Penal me të cilat mbrojtja e punonjësve mediatik do të ngrihet në një nivel më të lartë. Sipas ministrisë, këto ndryshime do të kontribuojnë në zvogëlimin e rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Me këto ndryshime ligjore të cilat janë ende në procedurë parlamentare, precizohen instrumente juridike dhe vepra penale që deri tani nuk ishin të përfshira me ligj, dhe kanë për qëllim që ti mbrojnë femrat nga shqetësimi dhe sulmet. Në listën e veprave penale është shtuar edhe “ndjekja” që përfshin edhe sanksione për shqetësim në internet. Kjo duhet ta përmirësojë sigurinë edhe të gazetarëve edhe të punonjësve mediatik që posaçërisht janë të ekspozuar këtë lloj kërcënimesh dhe

presionesh të jashtme³. Në ndryshimet ligjore tek Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje ndërkohë planifikohet ulja e lartësisë së gjobave për shpifje dhe ofendim, nga maksimumi prej 2 mijë eurosh në maksimum prej 400 eurosh.

Në pjesën e reformave sistemore tek mediat ende ka ngecje e cila nuk ishte tejkaluar edhe pas formimit të përbërjes së re parlamentare pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në korrik të vitit 2020, dhe pas formimit të komisioneve parlamentare në të cilat ishin bllokuar disa procese të rëndësishme për reformat mediatike. Paralajmërimet e shumta për zgjidhje për reformat e bllokuara nuk u realizuan as gjatë pjesës së dytë të vitit 2021, ndërsa nuk ka lëvizje as në aspekt të reformave në servis publik RTVM.

Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vazhdimësi kundërshtojnë paralajmërimet e ndryshme për ndryshime të mundshme ligjore me të cilat do të mundësohej reklamimi shtetëror në media. Sipas shumicës së organizatave mediatike dhe gazetareske, kthimi i reklamimit politik në

3 Në tekstin e propozuar parashikohet që: “Ai që në mënyrë të pa autorizuar ndjekë, përndjekë apo në çfarëdo mënyre përzihet në jetën personale të ndonjë personi tjetër, apo do të vendosë ose tenton të vendosë kontakt të padëshiruar, duke lëvizur në hapësirën ku gjendet ai person, me keqpërdorimin e të dhënave personale, me shfrytëzimin e mjeteve për informim publik apo mjete të tjera të komunikimit, apo në mënyrë tjetër do të shqetësojë, frikësojë dikë në mënyrë psikike, do të dënohet me gjobë apo me burg deri në tre vite”.

media do të nxisë klientelizmin në media dhe në mënyrë të konsiderueshme do të cenojë punën e tyre të pavarur dhe profesionale.

Duhet të shtohet edhe fakti se tregu i ndarë mediatik vazhdon të ndikojë tejet negativisht në qëndrueshmërinë financiare të mediave, prandaj për shkak të këtyre arsyeve dhe faktorëve negativ socio-ekonomik, mediat janë të ekspozuara në mënyrë të vazhdueshme ndaj ndikimit të faktorëve ekonomik dhe politik, gjë që të ndikon negativisht në të drejtat dhe liritë e mediave. Këto faktorë të vazhdueshëm që vështirësojnë punën e mediave, e ulin kapacitetin e tyre që ta përforcojnë pavarësinë dhe të ballafaqohen në mënyrë efikase me sfidat e erës së re digjitale. Një prej problemeve më serioze me të cilat ballafaqohen mediat në këtë periudhë të re të digjitalizimit është moria e dezinformatave që vijnë nga komunikimi publik, që krijohen dhe publikohen nga qendra të ndryshme që janë të interesuara për polarizimin e shoqërisë dhe për humbjen e besimit tek institucionet dhe mediat.

Gjendja e mediave në shtet u përkeqësua edhe më shumë me pandeminë e virusit Korona, gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021. Kriza shëndetësore dhe pastaj shoku ekonomik ndikuan në rënie të standardit social të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, dhe si pasojë e kësaj edhe u rrit rreziku për humbjen e vendeve të punës, për pagat e parregullta dhe vështirësitë e tjera financiare.

Në mënyrë që të tejkalohen këto probleme të komplikuar, është e nevojshme që të jepet mbështetje e vazhdueshme për mediat dhe përmirësimin e kushteve të tyre për punë, ndërsa duhet përforcuar shoqatat e besueshme dhe relevante mediatike dhe organizatat sindikaliste që kujdesen për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave profesionale të punonjësve mediatik pasi kjo është e një rëndësie tejet të veçantë. Një prej hapave të nevojshëm në këtë drejtim është mbledhja e të dhënave relevante dhe të përditësuara të vetë shoqatës së gazetarëve lidhur me gjendjen dhe kushtet për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Mediat janë një prej sektorëve më dinamik të shoqërisë, prandaj zgjidhja e koordinuar dhe e planifikuar e problemeve të kësaj sfere, është e kushtëzuar në masë të madhe nga mbledhja dhe analiza e të dhënave të besueshme për problemet me të cilat ballafaqohen gazetarët dhe punonjësit mediatik. Informacionet e besueshme dhe të freskëta për këto procese janë një element kyç për determinizimin e qasjes së duhur, për masat dhe metodat për zgjidhjen e çështjeve më të rëndësishme të kësaj sfere.

2

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit

Përforcimi i shoqatave mediatike dhe organizatave relevante sindikaliste të cilat kujdesen për mbrojtjen e interesave profesionale dhe punëtore të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, është tejet me rëndësi, prandaj edhe është qëllimi kryesor që e ka ky hulumtim. Në mënyrë që të ndihmohet dhe përforcohet puna e punonjësve mediatik, dhe që të zgjidhen problemet e sferës mediatike në mënyrë të planifikuar dhe të koordinuar, doemos duhet të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i gjendjes reale dhe problemeve të shoqërisë mediatike, si vlerësim dhe analizë e faktorëve kryesor, mënyra dhe metoda për tejkalimin e tyre.

Pikërisht vlerësimi i gjendjes reale të shoqërisë mediatike është qëllimi kryesor i këtij hulumtimi. Një prej hapave të nevojshëm në këtë drejtim është mbledhja e informacioneve relevante dhe të përditësuara nga vetë gazetarët dhe punonjësit mediatik. Informatat nga gazetarët dhe punonjësit mediatik të cilët çdo ditë ballafaqohen me probleme dhe sfida të ndryshme, janë hallka kryesore në përcaktimin e qasjes së duhur për zgjidhjen e çështjeve më të rëndësishme të sektorit mediatik.

Duke marrë parasysh gjithë këtë, hulumtimi i detekton përvojat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në fushat në vijim:

- Respektimi i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, me fokus të veçantë mbi lirinë e mediave.

- Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik.
- Të drejtat punëtore të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.
- Barazia gjinore dhe implementimi i aspektit gjinor në punën e mediave.

Qasja metodologjike në hulumtim

Në këtë hulumtim parimisht janë shfrytëzuar metodat e anketave dhe fokus grupeve, si dhe bisedave konsultative me personat e anketuar të cilët në këtë proces hulumtues kanë qenë kryesisht gazetarë dhe punonjës mediatik. Kjo qasje e hulumtimit mundësoi mbledhjen e informacioneve nga të anketuarit të cilët ballafaqohen në mënyrë direkte me temat që janë pjesë e hulumtimit. Mbledhja dhe ndarja e informacioneve dhe përvojave gjeneron një bazë të të dhënave të cilat mund të shfrytëzohen për definim, precizim, masa, strategji dhe politika efektive për ballafaqim me problemet kyçe në sferën mediatike. Përpos gazetarëve, në procesin hulumtues ishin të përfshirë edhe punonjësit mediatik (kameramanët, fotoreporterët, redaktorët grafik, teknikët dhe personat e tjerë nga sfera mediatike).

Për nevojat e hulumtimit ishin zhvilluar pyetësorë, ishte zhvilluar trajnim me ekip nga shtatë anketues të cilët e kanë zhvilluar anketën, ndërsa janë organizuar edhe mbledhje konsultative ,e gazetarë dhe punonjës mediatik në shtatë qendrat rajonale të SHGM-së (Shkup, Tetovë, Ohër, Manastir, Strumicë, Shtip dhe Kumanovë).

Pyetësori për mbledhje të të dhënave nga të anketuarit ishte formuar nëpërmjet përpunimit të pyetjeve të grupuara në mënyrë tematike, të cila burojnë nga variablat (të ndryshueshme) e vërtetuara dhe indikatorët (treguesit), në mënyrë që të vihet deri tek të dhënat e kontekstualizuara dhe të përditësuara si në aspekt kualitativ (vlerësues dhe perceptues) ashtu edhe në aspekt kuantitativ (statistikor).

Pyetësori ishte vendosur dhe plotësohej online, nëpërmjet platformës “Google Forms” dhe përbëhej prej tre pjesëve:

- a) Informacione të përgjithshme për të anketuarin.
- b) Informacione për sigurinë në punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut.
- b) Informacione për respektimin e të drejtave personale, profesionale dhe të drejtat kolektive punëtore të anëtarëve të sferës mediatike në Maqedoninë e Veriut.

Stili i pyetjeve nga pyetësori është e tipit standard, ku prej të anketuarit kërkohet që të përgjigjet në një seri pyetjesh nga tema të përgjithshme deri te ato specifike, duke bërë zgjedhje në grupin përgjigjeve të ofruara. Këto pyetje për të anketuarit ishin përpiluar mbi dy teknika metodologjike:

- Zgjedhje ose konfirmim i treguesit të vërtetuar në lidhshmëri me variablen e dhënë, si për shembull: “Sa kohë në total jeni të angazhuar në sektorin mediatik” me përgjigjet e dhëna : Më pak se një vit, 1-3 vite, 3-5 vite, 5-10 vite, dhe mbi 10 vite.
- Shkallëzimi i treguesve të vendosur që rrjedhin nga korrelacioni me një variabël të caktuar, si p.sh: “A pajtoheni me pohimin: Mendoj që ta lë apo ta ndryshoj profesionin”, me mundësi për përgjigje: plotësisht pajtohem, pjesërisht pajtohem, nuk pajtohem, pjesërisht nuk pajtohem dhe aspak nuk pajtohem, si dhe një mundësi shtesë që i anketuari të mos japë përgjigje.

Për tema të caktuara dhe hulumtimin e indikatorëve të tyre, ishin përfshirë edhe dy lloje pyetjesh metodologjike: (a) Pyetje të llojit të hapur, (b)hapësirë për koment të të anketuarit. Po ashtu, në kombinim me qasjet e mëparshme metodologjike, ishte shfrytëzuar edhe metoda e desk-analizës së materialeve relevante me interes dhe rëndësi për hulumtimin, që përfshinte edhe analizë përmbajtjesore dhe analizë tjetër të kornizës ligjore, hulumtimet, analizat, intervistat dhe raportet mediatike të disponueshme.

Anketa ishte realizuar në periudhën prej 9 gushtit deri më 17 shtator të vitit 2021, dhe ka përfshirë 335 të anketuar – gazetarë dhe punonjës mediatik. Takimet konsultative në nivel rajonal kanë përfshirë afërsisht 100 gazetarë dhe punonjës mediatik.



GJETJET KRYESORE NGA ANKETA E ZHVILLUAR

Gjendja socio-ekonomike e gazetarëve dhe punonjësve mediatik

Sipas rezultateve nga hulumtimi dhe të dhënat e fituara nga të anketuarit, ishte vërtetuar se një numër i lartë prej 41.6 përqind të gazetarëve dhe punonjësve mediatik të anketuar, janë të punësuar me afat të përcaktuar kohor punojnë me kontratë në vepër apo me honorarë. Kjo gjendje e të punësuarve dhe trendët në tregun e punës në sferën mediatike, krijojnë një paqartësi për të punësuarit lidhur me qëndrueshmërinë e vendeve të tyre të punës. Ndaj kësaj në mënyrë plotësuese ndikon edhe fakti që të ardhurat mujore më të ulëta se 30 mijë denarë i kanë 72.9 përqind e të anketuarve, që është afër kufirit të pagës mesatare në shtet. Paga të rregullta mujore kanë 80 përqind e të anketuarve, ndërsa thuhet një e treta (32.8%) vlerësojnë se gjendja e tyre materiale nuk është ndryshuar në tre vitet e fundit. Më shumë se gjysma e të anketuarve, 57.7 përqind janë të pakënaqur nga të ardhurat e tyre mujore dhe nga siguria e tyre ekonomike. Këto të dhëna e vërtetojnë **gjendjen e keqe socio-ekonomike**

të shumicës së të punësuarve në sektorin mediatik, edhe atë në vazhdimësi gjatë viteve të fundit.

Kushte për punë dhe transformim digjital

Sipas të anketuarve, 38.5 përqind prej tyre punojnë mbi 40 orë në javë, ndërsa kompensim për punën jashtë orarit nuk marrin madje 67.2 përqind. Trendet e reja të redaksive të integruara në të cilat bëjnë pjesë edhe platformat online për informim nëpërmjet cikleve të publikimit të lajmeve 24/7, imponojnë presion shtesë ndaj të punësuarve në media pasi që kapacitetet e medias nuk rriten në pajtueshmëri me rritjen e produksionit dhe cikleve informative. Po ashtu, sigurim për mbrojtje nga aksidentet gjatë punës kanë vërtetuar se kanë vetëm 38 përqind e të punësuarve, që është një përqindje tejet e ulët, sidomos duke marrë parasysh rrezikshmërinë e punës së mediave, sidomos asaj të terrenit.

Organizimi sindikalist

Në sindikatë apo në formë tjetër të organizimit profesional janë të anëtarësuar 45.4 përqind nga gazetarët dhe punonjësit mediatik të anketuar, ndërsa më shumë se gjysma, apo 53.7 përqind e të anketuarve, vlerësojnë se janë mjaftueshëm të informuar për mbështetjen nga ana e Sindikatës së pavarur të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Këto përqindje janë një bazë solide e cila mundëson punë efikase të sindikatave, por në të njëjtën kohë ekziston hapësirë për rritjen dhe kyçjen më të madhe të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në aktivitete të cilat do ta përforconin ndikimin e tyre në proceset e vendimmarrjes për të drejtat, kushtet për punë, dhe sigurinë e tyre.

Barazia gjinore

Më shumë se gjysma e të anketuarve (52.2 përqind) kanë dhënë notën më të lartë për nivelin e promovimit dhe respektimin e mundësive të barabarta të të punësuarve në media, pa dallim gjininë e tyre. Diçka më pak se gjysma e të anketuarve (47.5 përqind) kanë dhënë notën më të lartë për mbrojtje dhe sanksionim nga dhuna seksuale në media, apo çfarëdo lloj dhune tjetër e bazuar në gjini. Hulumtimi ka treguar se ky perceptim i të anketuarve megjithatë është bazuar në një kuptim më të ngushtë të barazisë gjinore, kryesisht në aspekt të ardhurave të punësuarve, kështu që duhet të rriten përpjekjet për aktivitete plotësuese si për shembull trajnime apo forma të tjera të edukimit për barazinë gjinore. Diçka më pak se gjysma, apo 44.2 përqind të anketuarve, vlerësojnë se burrat dhe gratë në media janë të paguar në mënyrë të barabartë për të gjitha pozicionet e punës. Po ashtu, një përqindje e lartë e të anketuarve, 40.3 përqind kanë thënë se nuk e dinë nëse në median ku punojnë ekzistojnë rregullore apo procedura për sigurimin e barazisë gjinore, ndërsa 18.5 përqind janë deklaruar se nuk ekzistojnë rregullore dhe procedura të tilla.

Siguria dhe presionet në punë

Thuajse gjysma e të anketuarve (48.4 përqind) kanë vërtetuar se rrallë ballafaqohen me presione të brendshme apo të jashtme në punën e tyre. Kërcënimet gjatë punës janë paraqitur tek 37.3 përqind e të anketuarve që është një përqindje e konsiderueshme dhe shqetësuese e cila na tregon se presionet dhe kërcënimet nuk janë përjashtime por një praktikë e rregullt dhe përvojë e shpeshtë e të anketuarve. Gazetarët dhe punonjësit mediatik më së shpeshti ballafaqohen me kërcënime nëpërmjet rrjeteve sociale (23.3 përqind), ndërsa kërcënime prej pronarëve të mediave apo redaktorëve kanë marrë 8.1 përqind e të anketuarve.

Pas kërcënimeve të marra, 17.7 përqind e të anketuarve kanë denoncuar kërcënimet në Shoqatën e Gazetarëve, ndërsa 15.9 përqind rastet e kërcënimit i kanë paraqitur në polici. Në pyetjen përse nuk i kanë paraqitur kërcënimet nëse kanë pasur, 14.9 përqind e të anketuarve kanë thënë se nuk kanë besim në gjyqësor, 14 përqind nuk kanë besim në polici, ndërsa 13.7 përqind nuk kanë besim në prokurori. Nëse këto të dhëna vihen në kontekst, dhe krahasohen me indikatorët e tjetër të pyetësorit, është shumë i dukshëm konstatimi se besimi i të anketuarve tek institucionet është shumë larg nivelit të kënaqshëm.

Nga siguria personale gjatë ushtrimit të detyrës janë të kënaqur 34.9 përqind e të anketuarve. Nëse këto të dhëna kryqëzohen me të dhënat e të punësuarve në media që kanë angazhime në terren, mund të konstatohet se një numër tjetër i vogël i atyre që punojnë në terren janë të kënaqur nga siguria personale gjatë ushtrimit të detyrave të punës.

Madje 59 përqind e të anketuarve vlerësojnë se rreziku më i madh në punën e tyre janë lodhja psikologjike dhe stresi, ndërsa 45.9 përqind e theksojnë rrezikun nga kërcënimet dhe llojet e ndryshme të dhunës psikologjike që çon në vlerësimin se ka nevojë për mbështetje shtesë për gazetarët dhe punonjësit mediatik në formën e masave parandaluese për mbrojtje, trajnimeve dhe këshillimeve për atë se si të ballafaqohen me këto sfida serioze.

Shifra prej 50.5 përqind e të anketuarve që mendojnë ta lëshojnë profesionin duket tejet shqetësuese dhe paraqet një të dhënë kumulative i cili përfshin të dhëna të ndryshme duke nisur prej gjendjen socio-ekonomike deri tek siguria e të anketuarve gjatë punës. Këto të dhëna tregojnë për nevojën e një qasjeje më gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave serioze në të cilën duhet një punë e vazhdueshme dhe bashkëpunim i instancave relevante në më shumë sektorë.

4


VËSHTRIM I REZULTATEVE TË ANKETËS

Karakteristikat demografike dhe profesionale të gazetarëve dhe punonjësve mediatik

Prej gjithsej 335 të anketuarve që janë përfshirë me këtë anketë, 54.6 përqind janë burra, 45.1 përqind janë gra, 0.3 përqind janë deklaruar si kategoria “tjetër”. Lidhur me moshën,


GRAFIKONI 1

Gjinia e të anketuarve



GRAFIKONI 2

Arsimi i të anketuarve



shumica (69 përqind) janë në moshë prej 26 deri 50 vjeç, 17.6 përqind janë më të moshuar se 50 vjeç, ndërsa 12.5 përqind janë më të rinj se 26 vjeç.


Sa i përket arsimit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik të anketuar gjatë këtij hulumtimi, shumica prej tyre – 54.9 përqind kanë arsim të lartë, 24.2 përqind janë me arsim të lartë, 10.4 përqind janë me shkollim pasdiplomik, ndërsa 9.6 kanë shkollim të lartë.

Shumica e të anketuarve – 57.6 përqind, punojnë si gazetarë ndërsa 42.4 përqind punojnë si punonjës mediatik⁴. Pjesa më e madhe (57.9 përqind) punojnë në sektorin mediatik për më shumë se 10 vite, 19.8 përqind kanë përvojë punë nga 1 deri në 5 vite, 15.8 përqind kanë përvojë pune nga 5 deri në 10 vjet, ndërsa 6.6 përqind punojnë në sektorin mediatik më pak se një vit.

4 Në pjesën e gazetarëve është përdorur definicioni për persona të angazhuar në media që punojnë në “mbledhje, konfirmim dhe analizim të informacioneve që lidhen me tema dhe ngjarje aktuale”, ndërsa në pjesën e “punonjësve mediatik”, janë theksuar në mënyrë specifike kameramanët, fotoreporterët, teknikët, ndihmësit teknik dhe persona të tjerë.

GRAFIKONI 3-4

Lloji i angazhimit në media dhe lloji i medias ku punojnë të anketuarit




Në pyetjen për llojin e medias në të cilin janë të angazhuar (grafikoni 6), shumica janë deklaruar se punojnë për media në nivel kombëtar apo 35.5 përqind e tyre, ndërsa 14.9 përqind punojnë në servis publik, 13.1 përqind punojnë në medium në nivel rajonal ndërsa 12.5 përqind punojnë në

medium në nivel lokal. Në mediat online punojnë gjithsej 17 përqind e të anketuarve, në media të shkruara 4.8 përqind, ndërsa në media të huaja janë të angazhuar vetëm 2.1 përqind të anketuarve.


GRAFIKONI 5

Kohëzgjatja e angazhimit në sektorin mediatik llogaritur në vite



GRAFIKONI 6

Lloji i medias ku janë angazhuar të anketuarit



Pozita ekonomike e gazetarëve dhe punonjësve mediatik

Në pyetjen për llojin e angazhimit të punës, 56.1 përqind nga të anketuarit kanë dhënë përgjigjen se janë të punësuar në mënyrë të rregullt me afat të pacaktuar, ndërsa 19.2 përqind e të anketuarve janë të punësuar me afat të caktuar. 10.4 përqind punojnë me kontratë në vepër, 12.2 përqind janë të angazhuar me honorar, 0.9 përqind janë deklaruar se punojnë në mënyrë vullnetare.

Në pyetjen e anketës “Sa janë të ardhurat tuaja mujore në median ku jeni të angazhuar/a” (grafikoni 8), plot 72.9 përqind e të anketuarve janë përgjigjur se të ardhurat mujore të


tyre nuk janë më të larta se 30 mijë denarë. Ndërkohë 38.2 përqind kanë të ardhura mujore prej 20 deri 30 mijë denarë. 28.4 përqind kanë të ardhura mujore prej 10 deri 20 mijë denarë. Ndërsa 6.3 përqind kanë të ardhura mujore më të ulëta se 10 mijë denarë.

Të ardhura mujore prej 30 deri 40 mijë denarë kanë 14.3 përqind e të anketuarve, ndërsa të ardhura mujore mbi 40 mijë denarë kanë vetëm 4.8 përqind e të anketuarve.

80 përqind e të anketuarve janë deklaruar se të ardhurat e tyre mujore janë të rregullta, ndërsa tek 11.9 përqind e të anketuarve të ardhurat vonojnë nga 1 deri në 3 muaj. Tek 1.5 përqind, të ardhurat vonojnë më shumë se 3 muaj, ndërsa 0.9 përqind kanë vonesa mbi 6 mujore.


GRAFIKONI 7

Lloji i angazhimit të punës së të anketuarve



GRAFIKONI 8

Të ardhurat mujore e të anketuarve në mediat ku punojnë




Në pyetjen se si e vlerësojnë gjendjen e tyre materiale në tre vitet e fundit, thuajse një e treta e të anketuarve (32.8 përqind) kanë deklaruar se situatën e kanë të pandryshuar. Ndërsa 30.1 përqind janë deklaruar se gjendja e tyre materiale është pjesërisht e përmirësuar. 11 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se gjendjen e tyre materiale e kanë pjesërisht më të keqe, ndërsa gjendjen më të keqe e kanë 10.7 përqind. 9.3 përqind nga të anketuarit janë deklaruar se kanë gjendje më të mirë materiale në mënyrë të konsiderueshme në tre vitet e fundit.

Në pyetjen se sa janë të kënaqur prej të ardhurave të tyre dhe siguria ekonomike, më shumë se gjysma (56.7 përqind) janë deklaruar se janë të pakënaqur. Ndërkohë 31 përqind janë tërësisht të pakënaqur, ndërsa 25.7 përqind janë kryesisht të pakënaqur. Plotësisht janë të kënaqur vetëm 2.7 përqind ndërsa kryesisht të kënaqur janë 22.4 përqind.


Në pyetjen plotësuese “A pajtoheni me deklaratën – Mendoj ta braktis apo ta ndryshoj profesionin”, madje gjysma e të anketuarve (50.5 përqind) janë deklaruar se pjesërisht (27.2 përqind) apo plotësisht (23.3 përqind) pajtohen me deklaratën. Nuk pajtohen me këtë deklaratë 27.2 përqind, plotësisht nuk pajtohen 17.9 përqind, ndërsa pjesërisht nuk pajtohen 9.3 përqind e të anketuarve.

GRAFIKONI 9-10

Rregullshmëria e pagave të të punësuarve në media (g.9) dhe ndryshimet në gjendjen materiale të të anketuarve në tre vitet e fundit (g.10)



- Të rregullta
- Vonojnë nga 1 deri në 3 muaj
- Vonojnë më shumë se 3 muaj
- Vonojnë më shumë se 6 muaj
- Refuzoj të përgjigjem



- Në mënyrë të konsiderueshme është përmirësuar
- Pjesërisht e përmirësuar
- E pandryshuar
- Pjesërisht është përkeqësuar
- Në mënyrë të konsiderueshme është përkeqësuar
- Refuzoj të përgjigjem

Të drejta dhe obligime në marrëdhëniet e punës

Në pyetjen se a ju kompensohet puna jashtë orarit të rregullt, 67.2 përqind janë deklaruar se nuk marrin kompensim, ndërsa 19 përqind kanë thënë se marrin kompensim. 10.7 përqind kanë dhënë përgjigjen se kompensohen pjesërisht.

Sa i përket harxhimeve për udhëtimet zyrtare, 45.2 përqind e të anketuarve kanë thënë se këto harxhime ua mbulon punëdhënësi, 35 përqind kanë deklaruar se nuk marrin kompensim për këto harxhime, ndërsa 16.8 përqind kanë thënë se vetëm pjesërisht u paguhet kompensim për udhëtimet zyrtare. Shfrytëzimi i makinës private për të kryer detyrat e

punës u lejohet vetëm 31.1 përqind të të anketuarve. Sigurim nga aksidentet apo fatkeqësitë kanë 38 përqind e të anketuarve, ndërsa 46.7 përqind kanë thënë se nuk kanë një sigurim të tillë.


Sipas numrit të orëve të punës në një javë, 49 përqind nga të anketuarit kanë thënë se punojnë prej 20 deri 40 orë, ndërsa 38.5 përqind punojnë mbi 40 orë në javë.

Thuajse një e treta e të anketuarve, 31.3 përqind kanë thënë se rrallë u ngarkohen angazhime pune pas orarit të rregullt, 29.6 përqind janë të angazhuar kohë pas kohe, ndërsa 20.3 përqind e të anketuarve kesi lloj angazhimesh kanë shpesh, ndërsa 5.1 përqind rregullisht.

Në pyetjen se sa janë të kënaqur nga mundësitë për avancim


GRAFIKONI 11

Niveli i kënaqësisë apo pakënaqësisë nga të ardhurat në median që punojnë apo siguria ekonomike




GRAFIKONI 12

Mbulimi i disa segmenteve të punës nga ana e punëdhënësit




GRAFIKONI 13

Numri i orëve të punës në një javë



GRAFIKONI 14

Angazhimi me detyra pune jashtë orarit të rregullt



profesional në punë, 44.5 përqind kanë thënë se janë të pakënaqur (27.8 përqind janë kryesisht të pakënaqur, ndërsa 16.7 përqind janë tërësisht të pakënaqur), ndërsa 32.3 përqind janë të kënaqur (4.5 përqind tërësisht, ndërsa 27.8 përqind pjesërisht).

Në kuadër të anketës, gazetarët dhe punonjësit mediatik të përfshirë në të kishin mundësi edhe për komente shtesë. Shumica e komenteve lidheshin me gjendjen e tyre të përkeqësuar materiale dhe financiare si dhe me mundësitë

e pakta për avancim dhe përmirësim në punë. Ata theksojnë se kanë paga të ulëta, punë të pakufizuar, puna jashtë orarit nuk u paguhet, dhe nuk janë madje as të siguruar nga lëndimet:

KOMENTI 1:

“SHTATË VITE JAM PA SIGURIM PENSIONAL, NDËRSA KAM VETËM 12 VITE STAZH. PO MENDOJ QË TA LË KËTË PROFESION. PËR KORRESPONDENTËT NUK KA ARDHMËRI”.

KOMENTI 2:

“NUK DUA QË TA LË GAZETARINË. ARSYEJA E VETME PËR PAKËNAQËSITË NË KËTË PROFESION JANË PAGAT E ULËTA. PËR NJË PAGË MË TË MADHE DO TË PUNOJA NË MEDIA TJETËR, POR NUK DO E LIJA GAZETARINË SI PROFESION”.

KOMENTI 3:

“MENDOJ SE PRONARËT E MEDIAVE DUAN QË TË ARRIJNË EFEKT MËKSIMAL NË FAVORIN E TYRE DUKE INVESTUAR MJETE MINIMALE. PRANDAJ EDHE NUK E PAGUAJNË PUNËN JASHTË ORARIT TË RREGULLT, NUK NA SIGUROJNË NGA LËNDIMET, PUNOJMË PËR FESTA DHE SHUMË GJËRA TË TJERA TË CILAT MBETEN PA PAGUAR NGA ANA E PRONARËVE”.

KOMENTI 4:

“KAMERAMANËT JANË FUTUR PADREJTËSISHT NË KATEGORINË TEKNIKË, DHE PËR KËTË SHKAK EDHE I KANË TË ARDHURAT SHUMË TË ULËTA, EDHE PSE PUNË E TYRE ËSHTË PRONË INTELEKTUALE DHE ËSHTË PJESË E PËNDASHME E KRIJIMTARISË SË NJË MEDIUMI, PA TË CILIN NUK MUNDET TË FUNKSIONOJË ASNJË TELEVISION”.

KOMENTI 5:

“DERISA PAGAT JANË TË ULËTA, ORARI I PUNËS I PA DEFINUAR, NDËRSA PUNË JASHTË ORARIT NUK PAGUHET, GAZETARËT KUALITATIV DO TË LËRGOHEN, NDËRSA NË VENDIN E TYRE DO TË VIJNË “FËMIJË” QË VETËM DO TI MBUSHIN ZBRAZËTIRAT”.

KOMENTI 6:

“NUK KA HAPËSIRË PËR AVANCIM PERSONAL. PASI QË TË ARRIHET NJË NIVEL I ÇAKTUAR I SUKSESIT. TREGU ËSHTË SHUMË I VOGËL DHE BAZOHET NË SENSACION DHE GJËRA TË ULËTA, NË VEND TË PROGRAMIT DHE PËRMBAJTJEVE KUALITATIVE”.

KOMENTI 7:

“KUALITETI I VEPRIMTARISË MEDIATIKE KA RËNË DUKSHËM NË 15 VITET E FUNDIT DHE ÇKA ËSHTË MË E KEQJA PO VAZHDON TË BËHET EDHE MË KEQ. KA SHUMË SERVLIZËM, DHE SHKATËRRIM TË SEKTORIT CIVIL SI NJË OPSION TË CILIT “DUHET DËGJUAR ZËRI”.

Organizimi sindikal dhe qasja ndaj sindikatave

Anketa ka vënë në dukje që 45.4 përqind e të anketuarve, janë të anëtarësuar në ndonjë sindikatë apo organizim i llojit tjetër profesional. Por, vetëm 17.9 përqind kanë vërtetuar se sindikata në median ku punojnë ka nënshkruar marrëveshje kolektive në emër të të punësuarve.

Një pjesë e të anketuarve 41.2 përqind, kanë marrë pjesë në trajnime për mënyrën e mbrojtjes dhe realizimin e të drejtave profesionale dhe punëtore në media, ndërsa më shumë se gjysma apo 53.7 përqind vlerësojnë se janë të informuar (14 përqind plotësisht, 39.7 përqind pjesërisht) për ndihmën dhe mbështetjen e gazetarëve dhe punonjësve


mediatik nga ana e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik. Diçka më shumë se një e treta e të anketuarve, 34 përqind, vlerësojnë se janë të painformuar (16.1 përqind kryesisht të painformuar, ndërsa 17.9 përqind plotësisht të painformuar):

Në pyetjen se a janë drejtuar për ndihmë deri tek ndonjë institucion apo organizatë në tre vitet e fundit, mbi 70 përqind kanë thënë se nuk kanë kërkuar ndihmë nga asnjë prej institucioneve apo organizatave të theksuara.

18.5 përqind e të anketuarve janë drejtuar tek Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut, 14 përqind kanë kërkuar ndihmë nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik, 5.2 përqind janë drejtuar tek Agjencia e Mediave, 5 përqind janë drejtuar deri tek ndonjë organizatë


GRAFIKONI 15

Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen “A jeni anëtarë në ndonjë sindikatë apo në ndonjë organizatë tjetër profesionale?”




GRAFIKONI 16

“A e dini se çfarë mbështetje dhe ndihmë ju ofrojnë SHGM dhe SPGM?”



GRAFIKONI 17

“A jeni drejtuar për ndihmë në tre vitet e fundit deri tek ndonjëra prej këtyre institucioneve apo organizatave?”



ndërkombëtare apo ambasadë e huaj, ndërsa 3.5 përqind e të anketuarve kanë kërkuar ndihmë nga Avokati i Popullit.

Sigurimi dhe respektimi i barazisë gjinore

Në pjesën e pyetjeve të anketës për barazinë gjinore në media, më shumë se gjysma e të anketuarve, 52.2 përqind kanë dhënë notën më të lartë për nivelin e promovimit të respektimit dhe mundësive të barabarta për të punësuarit në media, pa dallim prej identitetit gjinor (grafikoni 17).


Poashtu, 47.5 përqind e të anketuarve kanë dhënë notën më të lartë për nivelin e mbrojtjes dhe sanksionimit të dhunës

seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës gjinore në media (grafikoni 18).

Vendosjen e femrave në pozita redaktuese apo menaxheriale në media, të anketuarit e kanë vlerësuar si vijon: 24.4 përqind me notën më të lartë (5), 16.2 përqind me (4) 31.5 përqind me (3), 14.7 përqind me (2) dhe 13.2 përqind me notën më të ulët (1). Në pyetjen për realizimin e të drejtave për pushim prindëror apo të lindjes, thajse një e treta nga të anketuarit apo 31.5 përqind kanë dhënë notën (3), pastaj vijojnë ata me notën (5) 22.9 përqind, me notën (4) 18 përqind, me notën (2) 15.6 përqind, dhe me notën (1) 15.6 përqind.


GRAFIKONI 18

Vlerësim prej 1-5 për promovimin e mundësive të barabarta bazuar në identitetin gjinor (g.17) dhe mbrojtja nga dhuna seksuale dhe me bazë gjinore (r. 18)



GRAFIKONI 19-20

Nota të të anketuarve për nivelin e barazisë gjinore në mediat e Maqedonisë së Veriut prej 1-5



Sa i përket barazisë gjinore gjatë shpërndarjes së detyrave dhe përgjegjësi, përsëri më e përfaqësuar është nota (3). Një e treta nga të anketuarit, 33 përqind, kanë dhënë notë mesatare (3), 20.8 përqind kanë dhënë notën (5), 15 përqind kanë dhënë notën (4), 16.5 përqind kanë dhënë notën (2), dhe 14.7 përqind kanë dhënë notën (1).


Në pyetjen “Në median ku punoni burrat dhe gratë a kanë të njëjtat pozicione të punës?” (grafikoni 19), 44.2 përqind janë përgjigjur me “po”, ndërsa 9 përqind me “jo”. Një përqindje e lartë prej 39.4 përqind janë përgjigjur se nuk e dinë, me gjasë për shkak se nuk kanë informacione për lartësinë e pagave të kolegëve dhe eprorëve të tyre.

Në pyetjen nëse në median ku punoni ekzistojnë procedura dhe rregulla për sigurimin dhe respektimin e barazisë gjinore, madje 40.3 përqind kanë deklaruar se nuk e dinë, ndërsa 18.5 përqind janë deklaruar se në mediat e tyre nuk ka rregullore dhe procedura të tilla. Vetëm 23 përqind janë deklaruar pozitivisht, ndërsa 9.3 përqind e të anketuarve vlerësojnë se vetëm pjesërisht ekzistojnë rregullore dhe procedura të tilla.

Me kryqëzimin e të dhënave nga rezultatet e anketës (të prezantuara në grafikonet 17-22), variacionet tek indikatorët tregojnë se perceptimi për respektimin e barazisë gjinore ka tendencë që të barazohet me lartësinë e të ardhurave

GRAFIKONI 21-22

A kanë gratë dhe burrat në media paga të njëjta (g.19), dhe a ka në median që punoni procedura të brendshme për respektimin e barazisë gjinore (g.20)



mes burrave dhe grave, ndërsa më të paktë janë treguesit dhe faktorët e tjerë për barazi gjinore siç janë rregulloret e brendshme dhe procedurat për barazi gjinore.

Në mënyrë plotësuese, në pyetjen nëse keni vizituar trajnim për barazi gjinore, përgjigje pohuese kanë dhënë vetëm 25.7 përqind e të anketuarve.

Siguria gjatë punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik

Në pyetjen se sa shpesh ballafaqohen me presione të brendshme dhe të jashtme gjatë punës, 12.5 përqind e të anketuarve janë përgjigjur se kjo ndodhë shpesh, ndërsa 2.1 përqind kanë thënë se çdo ditë ballafaqohen me ndonjë formë të presionit. Thuajse gjysma e të anketuarve, 48.4 përqind, kanë deklaruar se ballafaqohen rrallë me presione. 21.8 përqind asnjëherë nuk janë ballafaqur me presion, ndërsa 15.2 përqind nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen.

Në pyetjen se sa janë të kënaqur nga siguria e tyre personale gjatë ushtrimit të detyrës, 34.9 përqind e gazetarëve dhe punonjësve mediatik të anketuar janë përgjigjur se janë kryesisht të kënaqur, ndërsa 9.6 përqind janë plotësisht të kënaqur. Plotësisht të pakënaqur nga siguria e tyre gjatë ushtrimit të detyrës janë 11.6 përqind, ndërsa kryesisht të pakënaqur janë 20.6 përqind.


Në pyetjen se a kanë marrë kërcënime gjatë punës, 37.3 përqind nga të anketuarit kanë konfirmuar se kanë marrë kërcënime gjatë punës prej të cilëve 36.4 përqind janë kërcënuar në mënyrë indirekte (nëpërmjet ndonjë personi tjetër apo nëpërmjet ndonjë mjeti të komunikimit), 0.9 përqind kanë marrë kërcënime direkte nga personi apo personat që i kanë përcjellë kërcënimet.

Gazetarët dhe punonjësit mediatik më së shpeshti kanë marrë kërcënime nëpërmjet rrjeteve sociale – 23.3 përqind, pastaj nëpërmjet telefonit – 20.3 përqind, ndërsa nëpërmjet postës elektronike 5.1 përqind e të anketuarve kanë marrë kërcënime. Nuk kanë marrë kërcënime 38.2 përqind e të anketuarve, ndërsa 10.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Në pyetjen se kush janë burime e kërcënimeve, 5.4 përqind janë përgjigjur se shpesh kanë marrë kërcënime nga shikuesit apo lexuesit, 4.2 përqind nga pronarët e mediave, 3.9 përqind nga redaktorët, 3.6 përqind nga reklamuesit apo se-


GRAFIKONI 23

“Sa shpesh ballafaqoheni me presion gjatë punës suaj në media?”




GRAFIKONI 24

“Sa jeni të kënaqur nga siguria e juaj personale gjatë ushtrimit të detyrave të punës?”




GRAFIKONI 25

Përgjigje të të anketuarve në pyetjen se a kanë patur kërcënime gjatë punës së tyre në media



GRAFIKONI 26

“Sa është niveli i juaj i besimit nga aspekti i sigurisë tek aktorët në vazhdim” (1 – nivelin më të ulët, 5 – nivelin më të lartë të besimit)



ktori i biznesit, 3 përqind nga politikanët apo pushteti, dhe 2.4 përqind nga policia.

Kur bëhet fjalë për atë se ku i kanë denoncuar kërcënimet, pjesa më e madhe e përqindjes së të anketuarve – 17.7 përqind, janë paraqitur te shoqatat e Gazetarëve, 15.9 përqind i kanë denoncuar kërcënimet në polici, 13.5 përqind tek organizatat sindikaliste, 7.8 përqind tek organizatat ndërkom-bëtare dhe ambasadat, 6 përqind tek shoqatat joqeveritare, ndërsa 5.1 përqind tek Avokati i Popullit⁵.

Në pyetjen se përse nuk kanë denoncuar nëse kanë pasur kërcënime (grafikoni 25), 14.9 përqind e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë besim në gjyqësor, 14 përqind se nuk kanë besim në polici, 13.7 përqind se nuk kanë besim në prokurori, ndërsa 8.1 përqind nuk kanë denoncuar kërcënim për shkak të frikës dhe pasigurisë.

5 Këto të dhëna janë të tipit lidhor, jo të ndarë, kjo do të thotë se të anketuarit në raste të ndryshme kanë praktikuar ta raportojnë rastin e njëjtë të kërcënimit në disa vende të ndryshme

Madje 59 përqind e të anketuarve vlerësojnë se rreziku më i lartë gjatë punës së tyre janë lodhja dhe stresi psikologjik, 45.9 përqind e theksojnë rrezikun prej kërcënimeve dhe llojeve të tjera të dhunës psikologjike, 36.9 përqind janë deklaruar se gjatë punës së tyre ekziston rrezik nga sulmet fizike, ndërsa 26.1 përqind si rrezik i kanë theksuar rreziqet nga lëndimet fizike gjatë punës.

Nga aspekti i sigurisë personale gjatë ushtrimit të detyrës në tubime publike apo protesta, 38.2 përqind kanë besim tek policia e rregullt. 29.8 përqind e të anketuarve janë deklaruar se kanë besim tek policia speciale dhe 16.6 përqind se kanë besim tek organizatorët.

Në pyetjen se a ballafaqohen me censurë apo vetë-censurë gjatë punës së tyre, 4.2 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se shpesh ballafaqohen me censurë, ndërsa 1.2 përqind se ballafaqohen me censurë çdo ditë. Vetë-censurë kanë përjetuar madje 7.5 përqind i të anketuarve.

Për sigurinë në punë, kërcënimet dhe rreziqet, disa prej të anketuarve kanë shpërndarë disa prej qëndrimeve dhe përvojave të tyre, në të cilat theksohen shembuj për mungesë të zgjidhjeve institucionale të rasteve të denoncuara për kërcënim. Po ashtu, nga komentet është e dukshme mungesa e besimit tek mbrojtja institucionale duke u bazuar në përvojat personale nga vetë të anketuarit:

KOMENTI 1:

“DERI TANI DISA HERË KAM PASUR KËRCËNIME DHE OFENDIME NGA FUNKSIONARË. KANË QENË TË DËNUARA NGA PUSHTETI POR SJELLJA E TYRE ASNJËHERË NUK KA MARRË NJË EPILOG BRENDA INSTITUCIONEVE”.

KOMENTI 2:

“ISHA I LËNDUAR NGA POLICIA GJATË NJË PROTESTE. E DENONCOVA RASTIN POR ASNJËHERË NUK DORËZOVA PADI NDAJ POLICIT”.

KOMENTI 3:

“ISHA GJYKUAR PËR TEKST TË PUBLIKUAR, NDËRSA UNË NGRITA KËRKESË KUNDËR NJË GAZETARI TJETËR I CILI MË KËRCËNOI FIZIKISHT, SE DO TË DJEGË, POR PROKURORIA PUBLIKE NUK E PRANOI RASTIN”.

KOMENTI 4:

“ISHA SULMUAR DERISA PO FILMOJA PËR NJË KRONIKË, POR NUK E PARRAQTJA RASTIN PASI QË ATA QË MË SULMUAN KISHIN NDIKIM NË POLICI DHE NË GJYQËSOR”.

Nga një pjesë e komenteve të të anketuarve dhe të përfshirëve në bisedat konsultuese, është e dukshme që ekziston një vetëdije e theksuar për nevojën e një organizimi të brendshëm më të mirë në media, si një mekanizëm kryesor për tejkallim të problemeve me të cilat ballafaqohen:

KOMENTI 5:

“GJITHË KËRCËNIMET, PAVARËSISHT SE SA TË VOGLA DUKEN NË SHIKIM TË PARË, DHE PAVARËSISHT SE PREJ KUJT VIJNË, DUHET TË DENONCOHEN NË SHGM DHE SINDIKATË DHE NË MËNYRË PLOTËSUERE NËSE BËHET FJALË PËR GAZETARË TANË TË KËRCËNUAR NË SHTET TJETËR, EDHE NË FEDERATËN NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE TË GAZETARËVE. PERSONALISHT PËR SHEMBULL, PAS NJË KËRCËNIMI PËR ARRESTIM GAZETARËSH NË NJË SHTET FQJNJ, KAM DENONCUAR RASTIN EDHE TEK LIDHJET NDËRKOMBËTARE TË GAZETARËVE TË CILËT REAGUAN MENJËHERË. ME KËTË RAST, DUKE MARRË PARASYSH MËSIMET NGA PËRVOJA IME, APELOJ DERI TEK TË GJITHË GAZETARËT QË DOMOSDOSHMËRISH TI DENONCOJNË KËRCËNIMET”.

KOMENTI 6:

“ISHA E SULMUAR NË FEJSBUK ME FJALË TË RËNDA VERBALE DHE OFENDIME NGA GAZETARJA J.I. E DENONCOVA EDHE NË MPB, EDHE NË SHGM, POR NGA TË DY VENDET MË THANË SE NUK MUNDEN TË REAGOJNË DHE SE PROBLEMIN DUHET TA ZGJEDHË NËPËRMJET PADISË CIVILE . POR UNË NUK E BËRA KËTË QË TË MOS EKSPONOHEM NË OFENDIME TË TJERA PREJ SAJ”.

KONKLUZA

Gazetarët dhe punonjësit mediatik që janë marrë në këtë hulumtim, kanë konfirmuar se gjenden në një situatë tejet të vështirë socio-ekonomike, ndërsa gjysma prej tyre madje po mendojnë që ta lejnë profesionin. Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë paga mujore, respektivisht paga dhe honorare shumë më të vogla se mesatarja në shtet (sipas Entit për statistikë paga mesatare neto e paguar në muajin korrik për një të punësuar është 28 540 denarë⁶). Përpos të ardhurave të ulëta, ky hulumtim vëri në dukje se madje një e treta e të punësuarve në sektorin mediatik punojnë me kontrata me periudhë të caktuar kohore, apo me honorare. Pasiguria në vendin e punës dhe zhvlerësimi i mundit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, ndikon negativisht në motivimin e tyre për të punuar, pror edhe e rritë rrezikun për korrupsion dhe kontroll nga qendra të ndryshme ekonomike dhe politike. Kushtet e këqija socio-ekonomike për punë të mediave janë pjesë e një ambienti më të gjerë në shtet në të cilin lidhen edhe faktorë të tjerë plotësues që janë specifike për sektorin si fragmentimi mediatik dhe funksionaliteti i dobët i tregut mediatik.

Sipas Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale, në fund të vitit 2020 gjithsej 110 radiodifuzerë komercial kanë emetuar program (45 televizione dhe 65 radio stacione) dhe katër radio jofitimprurëse⁷. Gjithsej 11 radiodifuzerë emetojnë program në nivel kombëtar (5 terestrial apo tokësor, 4 kabllovik dhe 2 televizione satelitore), 18 në nivel rajonal dhe 16 në nivel lokal. Prej radio stacioneve, 4 emetojnë program në nivel kombëtar, ndërsa

6 Burimi, ESSh: <https://is.gd/ZbgoaH>

7 Të hyrat e përgjithshme në industri në vitin 2020 kanë qenë 2.382,61 milionë denarë. Më shumë se gjysma e tyre kanë qenë të hyrat e televizioneve komerciale – 1.217,88 milionë denarë (51,12 përqind). Servisi publik ka realizuar të hyra në vlerë prej 1.012,19 milionë denarë (42,58 përqind), ndërsa të hyrat e radiove komerciale kanë qenë 152,54 milionë denarë (6,4 përqind), ASHMAA, viti 2020.

17 në nivel rajonal, ndërsa të tjerët emetojnë program vetëm në nivel lokal. Në mënyrë shtesë, në listën e mediave profesionale online janë regjistruar 101 anëtarë por numri real i mediave online është rreth 200, duke marrë parasysh se në vitin 2020, gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, madje 235 portale janë paraqitur në regjistrin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për të reklamuar pjesëmarrësit në zgjedhje. Për këtë shkak por edhe për shkak të faktorëve socio-ekonomik, mediat janë nën ndikim të theksuar të faktorëve të jashtëm të fuqisë, gjë që reflektohet negativisht jo vetëm në paanshmërinë dhe profesionalizmin e tyre por edhe në realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Më pak se gjysma e të anketuarve kanë deklaruar se janë të anëtarësuar në ndonjë sindikatë, ndërsa numri i anëtarëve në sindikata korrespondon afërisht me përqindjen e atyre që kanë ndjekur trajnime për mbrojtje dhe realizim e të drejtave profesionale dhe punëtore në media. Hulumtimi po ashtu nxori në pah edhe se mbi gjysma e të anketuarve vlerësojnë se janë të informuar për ndihmën dhe mbështetjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatic nga ana e Sindikatës së gazetarëve dhe punonjësve mediatic. Këto gjetje dëshmojnë se vetëdija për organizimin sindikalist mes gazetarëve është në gjendje solide, por se ka hapësirë edhe për më shumë aktivitet të vazhdueshëm dhe bashkëpunim me gazetarët dhe punonjësit mediatic.

Informimi më i mirë dhe trajnimi për organizimin dhe veprimin sindikalist, në mënyrë të konsiderueshëm mund ta përmirësojë kapacitetin e organizatave sindikale dhe me këtë ta përforcojë ndikimin dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatic

Hulumtimi ka treguar se edhe pse gazetarët dhe punonjësit mediatic ndjehen kryesisht të sigurt gjatë kryerjes së detyrave (44.5 përqind), megjithatë nuk i vogël numri i atyre që nuk ndjehen të sigurt (32.2 përqind), si dhe i atyre që ballafaqohen me kërcënime të ndryshme direkte dhe indirekte. Më së shpeshti kërcënimet vijnë nëpërmjet rrjeteve sociale, ndërsa burimet më të shpeshta të kërcënimeve janë

pronarët e mediave dhe redaktorët, publiku (lexuesit dhe shikuesit), forumi biznesor, pushteti dhe politikanët, por edhe policia. Pas kërcënimeve të marra, të anketuarit më së shpeshti janë drejtuar tek shoqatat e gazetarëve, policia dhe organizatat sindikaliste. Ata që kanë qenë pre e kërcënimeve në fakt nuk i kanë denoncuar ato, dhe kanë theksuar se arsyeja për këtë gjë është mungesa e besimit tek gjyqësori, policia dhe prokuroria, ndërsa një pjesë e tyre për shkak të frikës dhe pasigurisë. Këto rezultate çojnë deri te konkluzat se gazetaria edhe më tej nuk është profesion mjaftueshëm i sigurt në këtë shtet, por edhe se gazetarët dhe punonjësit mediatic ende nuk kanë besim tek institucionet të cilat duhet ti mbrojnë të drejtat e tyre dhe ti sanksionojnë personat përgjegjës për kërcënimet dhe sulmet ndaj tyre.

Gazetarët dhe punonjësit mediatic e përjetojnë profesionin e tyre si skajshmërisht të rrezikshme dhe me stres. Sipas tyre, një rrezik tejet të lartë në punën e tyre paraqesin lodhja psikologjike dhe stresi e pastaj edhe rreziku nga kërcënimet dhe lloje të tjera të dhunës psikologjike, rreziku nga sulmet fizike si dhe rreziku nga lëndimet fizike në punë.

Po ashtu, platformat e reja digjitale për informim publik, kanë sjellë ndryshime të konsiderueshme edhe në pjesën e cikleve të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatic. Në erën e internetit dhe rrjeteve sociale, standardet e krijimit dhe përditësimit të informacioneve dhe përmbajtjeve mediaticke, janë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, kështu që sot të punësuarit në media ballafaqohen me realitetin e cikleve të pandërprera (24/7) të mbledhjes dhe publikimit të informacioneve. Kjo imponon presion shtesë tek të punësuarit dhe e zgjatë orarin e tyre të punës jashtë gjithë standardeve të orëve të punës si në nivel ditor ashtu edhe në nivel javor. Thuajse një e treta e të anketuarve kohë pas kohe marrin kërkesa për detyra jashtë orarit të punës, ndërsa më shumë se një e treta kanë konfirmuar se punojnë mbi 40 orë në javë. Në mënyrë përmbledhëse, mbi gjysma e të anketuarve kanë thënë se punojnë në kushte kur kanë orare të gjata dhe të pa sigurta. Kjo krijon presion shtesë tek gazetarët, sidomos nëse merret parasysh thuajse dy të tre-

tat e gazetarëve dhe punonjësve mediatic të anketuar nuk paguhen për punën jashtë orarit të rregullt.

Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë dhënë notën më të lartë për nivelin e promovimit dhe respektimit të mundësive të barabarta të të punësuarve në media, pavarësisht gjininë e tyre. Diçka më pak se gjysma e të anketuarve kanë dhënë notën më të lartë edhe për nivelin e mbrojtjes dhe sanksionimit të dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës bazuar në gjini tek mediat.

Por 40.3 përqind e të anketuarve nuk e dinë nëse në median që punojnë ka rregullore apo procedura për sigurimin e barazisë gjinore, ndërsa vetëm një e katërta kanë pasur trajnime për barazi gjinore. Këto të dhëna dëshmojnë se qasja e ndjeshme në aspekt gjinor nuk është e integruar tërësisht në punën e redaksive, se në një numër të madh redaksish nuk ka politika apo procedura të brendshme për të integruar barazinë gjinore në funksionimin e tërësishëm të mediave edhe në përmbajtjet mediatiche, si dhe faktin që gazetarët dhe punonjësit mediatic nuk janë të edukuar thellësisht për këtë temë.

- Gazetarët dhe punonjësit mediatic gjenden në **situatë skajshmërisht të keqe socio-ekonoike dhe gjysma e tyre mendojnë që ta lejnë profesionin.**
- Të anketuarit profesionin e tyre e përjetojnë si tejet stresues dhe të rrezikshëm, ndërsa **rrezik i lartë plotësues në punën e tyre janë edhe lodhja dhe stresi psikologjik.**
- Më shumë se një e treta, respektivisht **37 përqind e të anketuarve kanë pohuar se kanë marrë kërcënime gjatë punës.** Prej tyre, 36 përqind kanë marrë kërcënime indirekte (nëpërmjet ndonjë personi apo nëpërmjet ndonjë mjeti të komunikimit).
- Të anketuarit **më së shpeshti marrin kërcënime në rrjetet sociale,** ndërsa burime më të shpeshta të kërcënimeve janë pronarët e mediave dhe redaktorët, publiku (lexuesit dhe shikuesit) forumi biznesor, pushteti dhe politikanët si dhe policia.

- Arsyet kryesore që ndalojnë gazetarët dhe punonjësit mediatic për të mos denoncuar kërcënimet janë: **mosbesimi në gjyqësor, polici dhe prokurori,** ndërsa një pjesë e tyre edhe **për shkak të ndjenjës së frikës dhe pasigurisë.**
- **Më pak se gjysma e të anketuarve janë deklaruar se janë anëtarë në ndonjë sindikatë,** ndërsa më shumë se gjysma prej tyre vlerësojnë se janë të informuar për ndihmën dhe mbështetjen për gazetarët dhe punonjësit mediatic që ofron Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatic.
- Platformat e reja digjitale për informim publik, përpos aspekteve pozitive, kanë sjellë edhe presione shtesë ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatic siç janë **zgjerimi i orarit të punës dhe eksponimi ndaj kërcënimeve dhe sulmeve online.**
- Thuajse një e treta e të anketuarve kohë pas kohe marrin kërkesa apo urdhra për kryerjen e detyrave jashtë orarit të punës, ndërsa më shumë se një e treta prej tyre kanë vërtetuar se punojnë më shumë se 40 orë në javë.
- Qasja e ndjeshme ndaj aspektit gjinor është e integruar tërësisht në punën e redaksive, në shumë media nuk ka politika dhe procedura të brendshme për integrimin e dimensionit gjinor, dhe vërtetohet nevoja për masa plotësuese, trajnime dhe edukim në këtë temë.

REKOMANDIME

Hulumtimi dhe rezultatet e fituara tregojnë se duhet më shumë përpjekje dhe aktivitete të mediave (para së gjithash pronarët dhe menaxhmenti) për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Krijimi i masave të ndryshme sociale, pagesat për punë shtesë jashtë orarit, mbulimi i harxhimeve gjatë punës në terren, ofrimi i sigurimit nga rreziqet, si dhe formimi i një fondi për përmirësimin e standardit në mediat, janë disa prej zgjidhjeve të mundshme në afat më të shkurtër, në mënyrë që të arrihet përmirësimi i kushteve socio-ekonomike për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në media. Në afat më të gjatë, të gjithë faktorët relevantë duhet të punojnë në mënyrë strategjike, të vazhdueshme dhe të koordinuar për krijimin e politikave afatgjate sistemore dhe masave për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Është e domosdoshme që të krijohet rregullim ligjor edhe për të drejtat e punëtorit për "freelance"-erët dhe për ata që punojnë me honorare, sidomos në pjesën e mbrojtjes së të drejtave të punëtorit. Është e nevojshme që të sigurohet më shumë transparencë tek mediat lidhur me pagesat dhe mbulimin e harxhimeve, marrëveshjet e lidhura dhe çështje të tjera të kësaj fushe për të cilat rekomandohet implementimit i procedurave transparente dhe të formalizuara, në dokumente të shkruara me marrëveshje individuale dhe kolektive, duke u ofruar sindikatave pjesëmarrjes dhe qasje të pa penguar në këto marrëveshjes .

Duhet të rishikohet korniza ligjore e cila shërben për rregullimin e obligimeve të punëdhënësve dhe punëtorëve, si dhe kompensimin për orarin e punës dhe orët e punës në marrëveshjet individuale dhe kolektive të punës në media.

Mediat duhet të nxiten dhe ndihmohen në zhvillimin e modeleve shtesë të biznesit dhe mundësive për fitim, sidomos nëpërmjet platformave digjitale dhe aplikacioneve dhe mjeteve

të ndryshme online, në mënyrë që të zvogëlohet varësia e tyre nga reklamuesit, donacionet dhe subvencionet. Rekomandohet që të zhvillohet një model shërbimi nëpërmjet të cilit do të rigjallërohet lidhja direkte financiare mes mediave dhe shfrytëzuesve. Sipas shembullit të mediave nga vendet e tjera të cilat tashmë i kanë krijuar këto modele dhe të cilët publikut të tyre i ofrojnë përmbajtje dhe oferta shtesë premium, është e mundur të bëhet një formë e përshtatshme për kushtet dhe standardet lokale, të kombinohen modele të shërbimeve me dhe pa pagesë, gjë që do tu mundësojë mediave që ta mbajnë publikun dhe në të njëjtën kohë do të arrijnë të përfitojnë burime shtesë financiare.

Ky proces kërkon kohë për inovacione, zhvillim të mjeteve dhe përmbajtjeve, si dhe përshtatje me publikun, por themelet për zgjidhjet e qëndrueshme socio-ekonomike në sektorin mediatik duhet të vendosen sa më shpejtë dhe ato duhet të mbështeten nga një rreth më i gjerë i aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu edhe institucionet e sistemit. Po ashtu mund të rekomandohet një analizë shtesë juridike për legjislativin relevant, që reflektohet mbi punën e mediave në temat me interes të këtij hulumtimi, në mënyrë që të detektohen mundësitë për përmirësimin e kushteve për punën financiare të mediave, si për shembull mundësitë për përshtatje apo lehtësime të caktuara tatimore, si dhe zgjidhje të tjera në këtë drejtim që do të mundësonin një garë të barabartë në tregun e sektorit mediatik.

Për përmirësimin e gjendjes, nevojitet edhe më shumë kontroll mbi punën financiare të mediave dhe më shumë

efikasitet të shërbimeve për inspektim, sidomos në aspekt të shkeljes së të drejtave punëtore dhe të drejtave nga marrëdhënia e punës së gazetarëve, punonjësve mediatik e administratës në media. Në këtë drejtim, SHGM dhe SPGM mund të japin ndihmë shtesë me informacione, udhëheqës, trajnime dhe theksim të mjeteve më të mira dhe praktikave për denoncim të rregullt të këtyre rasteve deri tek shërbimet e inspektimit dhe institucionet përgjegjëse.

Në mënyrë që të rritet dhe forcohet ndikimi i sindikatave, dhe kështu të përmirësohet edhe pozita negociuese dhe vendosësh e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në media, është e nevojshme që SHGM dhe SPGM, por posaçërisht sindikata, pasi që tema për të drejtat e punëtorëve është pjesë e misionit të kësaj organizate, që në vazhdimësi të krijojë dhe ndërmarrë fushata informative dhe edukative për nxitjen dhe motivimin e gazetarëve dhe punonjësve mediatik që të jenë solidar dhe aktiv në aspekt sindikal. Duhet zhvilluar përfshirja e të punësuarve në media dhe kulturën profesionale se nëpërmjet organizimit sindikalist, në mënyrë të konsiderueshme mund ta përmirësojnë pozicionin negociues të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në të gjitha proceset që i prekin të drejtat e tyre, liritë dhe kushtet në të cilat punojnë.

Për përmirësimin e sigurisë së të punësuarve në media, nevojiten një varg masash si në aspekt juridik ashtu edhe në aspekt të ndërmarrjes së masave konkrete për sigurimin e tyre fizik.

Ndryshimet në kornizën ligjore nga korriku i vitit 2021, që ende janë në procedurë parlamentare, në të cilat sulmet ndaj gazetarëve duhet të trajtohen si sulme ndaj personave zyrtarë, janë një hap që mund të përmirësojë gjenden nëse zbatohet në mënyrë të drejtë dhe konzistente.

Precizimi i definimit juridik të gjuhës së urrejtjes në pajtueshmëri me praktikën e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, si dhe plotësimi i autorizimeve dhe ekspertizës së prokurorisë për kësi raste duke bërë trajnime dhe grupe të posaçme të punës që do të merreshin në mënyrë më specifike dhe më të fokusuar me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, janë masa që mund ta fuqizojnë zbatimin e instrumenteve juridike dhe ta kthejnë besimin në institucione që sipas hulumtimit nuk është në nivel të kënaqshëm.

Në mënyrë shtesë, mediat në bashkëpunim me SHGM-në dhe Sindikatën, por edhe me sektorin civil dhe institucionet, mund të sigurojnë një mbështetje të fortë për sigurinë e të punësuar në mediat. Kjo duke përgatitur materiale informuese, hulumtime të rasteve më specifike, trajnime, sigurim i pajisjeve dhe duke ndërtuar dhe zbatuar politika, procedura dhe protokolle adekuate të brendshme për siguri.

Është e nevojshme që të përforcohen aktivitetet dhe mekanizmat për mbështetje të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në aspekt të zvogëlimit të presionit të përditshëm, lodhjes dhe stresit psikologjik. Është tejet me rëndësi që ata të kenë qasje deri tek ndihma adekuate psikologjike, këshillimi dhe edukimi, pasi vetëm në këtë mënyrë ata mund ti tejka-

lojnë presionet dhe problemet me të cilat ballafaqohen për çdo ditë gjatë punës së tyre.

Për këtë gjë duhet sensibilizim edhe nga ana e mediave, respektivisht nga pronarët e mediave dhe redaktorët duke organizuar ngjarje publike, debate, trajnime, materiale edukative dhe hulumtuese dhe masa të tjera adekuate për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit për këtë problem serioz.

Në aspekt të barazisë gjinore dhe implementimit të saj në funksionimin e mediave, redaksive si dhe produksionit të përmbajtjeve mediatike, është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse, sistematike, e cila do të përfshijë të gjithë nivelet, prej pronarëve të mediave, gazetarëve e deri te punonjësit mediatik. Duhet sensibilizim dhe edukim për rëndësinë por edhe për mënyrat se si të implementohet tërësisht dimensionin gjinor në punën e mediave. Kjo do të thotë se nevojiten trajnime, konsultime për krijimin dhe zbatimin e politikave dhe praktikave adekuate për barazi gjinore siç janë për shembull rregulloret, protokollat dhe implementimi i këtij aspekti në marrëveshjet e punës por edhe tek marrëveshjet kolektive.

REKOMANDIME KONKRETE:

- Nevojiten më shumë aktivitete të mediave (pronarëve, menaxhmentit) për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në formë të masave të ndryshme sociale, benefiteve, pagesave të punës shtesë, sigurimin nga rreziku, si dhe fonde për përmirësimin e standardit të të punësuarve në media.
- Përpos hulumtimit të mundësive dhe metodave për caktim të benefiteve të caktuara dhe subvencioneve, mediat duhet të nxiten dhe të mbështeten në zhvillimin e modeleve biznesore shtesë dhe mundësive për përfitim, sidomos duhet zhvilluar shërbime dhe modele biznesore që do ta gjallërojnë lidhjen direkte financiare mes mediave dhe përdoruesve.
- Nevojitet kontroll më i mirë ndaj punës financiare të mediave dhe më shumë angazhim të inspektorëve, sidomos tek rastet e shkeljes së të drejtave të punëtorëve dhe të drejtave nga marrëdhënia e punës së të punësuarve në media.
- Me rëndësi është që të rritet mbështetja për sigurinë e të punësuarve në media duke përgatitur materiale informuese, studime hulumtuese për raste më specifike, trajnime, sigurim të pajisjeve, si dhe krijimin e zbatimit e politikave të brendshme adekuate, procedurave, rregulloreve e protokolleve të sigurisë. Për këtë gjë mund të kontribuojnë shumë ngjarjet e përbashkëta, debatet, trajnimet, aktivitetet e koordinuara me institucionet si MPB, prokuroria, Ministria e Drejtësisë dhe institucione

e trupa të tjerë, në bashkëpunim edhe me SHGM-në dhe SPGM-në.

- Duhet që të përforcohen aktivitetet për mbështetje të gazetarëve dhe punonjësve mediatik për tejkalimin e lodhjes dhe stresit psikik duke pasur një qasje të lehtë deri tek ndihma psikologjike, këshillimi dhe mundësitë për trajnime parandaluese dhe edukim për këto dukuri.
- Duhet të ndërmerren aktivitete edukative dhe informative të vazhdueshme në formë të fushatave për nxitje dhe motivim të gazetarëve dhe punonjësve mediatik të jenë solidar dhe të organizuar në mënyrë aktive në organizime sindikale.
- Duhet sensibilizim dhe edukim për rëndësinë dhe mënyrat e implementimit të plotë të dimensionit gjinor në punën e mediave por edhe në produksionin e përmbytjeve mediatike.

KY HULUMTIM KA PËRFSHIRË ANKETË DHE TAKIME KONSULTUESE ME GAZETARË DHE PUNONJËS MEDIATIK TË KËTIJ SHTETI, NDËRSA U REALIZUA NË KUADËR TË PROJEKTIT "PUNONJËS TË SIGURT MEDIATIK PËR GAZETARI KUALITATIVE NË MAQEDONI", QË ËSHTË MBËSHTETUR NGA FONDI BALLKANIK PËR DEMOKRACI, NËPËRMJET FONDIT GJERMAN TË MARSHALIT NGA SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS DHE MINISTRISË SË JASHTME NORVEGJEZE.

BIBLIOGRAFIA

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale (2021), “Analizë e tregut të shërbimeve audio dhe audio-vizuale për vitin 2020” Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale (2019), “Strategjia rregullatore për zhvillim të veprimtarisë audio dhe audio-vizuale për periudhën nga 2019 deri në 2023, Shkup, Maqedonia e Veriut.

Baçovska, Jasna, Mihajlova, Elena dhe Shekerxhiev, Tome, (2013), “Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes”, Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE), Shkup, 2013.

Enti Shtetëror i Statistikës (2021) “Paga mesatare mujore neto për të punësuar në muajin korrik të vitit 2021”, e disponueshme në <https://is.gd/ZbgoaH> (qasur më 25.10.2021).

Ferrier, M. (2018), Attacks and harassment. The impact on female journalists and their reporting. International Women’s Media Foundation.

Floridi, L. (2013), The Ethics of Information, Oxford, Oxford University Press.

Horner, S. David (2015), Understanding Media Ethics, SAGE, London.

Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-vizuale (2020).

Ligji për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Media, 2014.

Ligji për Marrëdhëniet e Punës – test i pastruar , 2015.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2021), Analizë: “Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV nëpërmjet prizmit të ligjeve aktuale, Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2020), “Indeksi i sigurisë së gazetarëve të Ballkanit Perëndimor Raport Narrativ”, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Rritje dramatike e sulmeve ndaj gazetarëve – kërkojmë zgjidhje urgjente”, Shkup: 2020, e disponueshme në <https://bit.ly/3fg9nbG> (qasur më 25.10.2021).

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2021), “Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut në 2020”, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Kostadin Bogdanov, Ivan Breshkovski, Dragan Sekullovski (2020), “Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal – Analizë e standardeve ndërkombëtare dhe rregullativës vendore”, SHGM dhe Konrad Adenauer Stiftung.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2014), “Doracak për sigurinë e gazetarëve”, e disponueshme në <https://www.osce.org/fom/118052> (qasur më 25.10.2021).

Organization for Security and Co-operation in Europe, The Representative on Freedom of the Media, Harlem Désir (2020), *Regular Report to the Permanent Council for the period from 21 November 2019 to 2 July 2020*, faq. 10-59.

OSCE RFoM (2015), Safety of Female Journalists Online, Organization for Security and Co-operation in Europe, The Representative on Freedom of the Media.

Promedia (2021), Regjistri i anëtarëve, e disponueshme në <https://is.gd/czblnU> (qasur më 25.10.2021).

RSF, Reporters Without Borders (2021), North Macedonia Report 2020, e disponueshme në <https://rsf.org/en/taxonomy/term/123> (qasur më 25.10.2021).

RSF, Reporters Without Borders (2020), Safety Guide for Journalists - A handbook for reporters in high-risk environments, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization publication.

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (2011), Rregullore për ndihmë juridike, SPGM, e disponueshme në <https://ssnm.org.mk/?p=66> (qasur më 14.10.2021).

Clark, M. and Grech, A. (2017), Journalists under pressure: Unwarranted interference, fear and self-censorship in Europe. Strasbourg: Council of Europe.

Council of Europe (2019), Democracy at risk: threats and attacks against media freedom in Europe. Annual Report by the Partner Organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists. Strasbourg: Council of Europe.

Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë - KEMM (2017), “Vetë-rregullim apo rregullim i mediave të internetit në Maqedoni”, Shkup.

Këshilli i Evropës (2021), “Platforma për promovim të mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve”, e disponueshme në <https://www.coe.int/en/web/media-freedom> (qasur më 14.10.2021).

Sonja Trajkovska Dimitrova (2018), “Pozicioni strukturor i gazetareve femrave në mediat në Maqedoni”, Shkup, IMM.

Sunai Sabrioski, Kristina Atovska (2021), 14 sulme ndaj gazetarëve – 14 goditje ndaj demokracisë, SHGM, Shkup.

UNESCO (2015), Building Digital Safety for Journalism, e disponueshme në <https://is.gd/CssLFT> (qasur më 14.10.2021).

UNESCO (2015), “Doracak për sigurinë e gazetarëve”, e disponueshme në https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/guide_journaliste_rsf_2015_en.pdf (qasur më 14.10.2021)



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë., Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.